



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 635/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, Kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada – Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtuar nga Zoran Cirkoviç, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik G.I. Narodna Slloka me seli në Lipjan, dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtuar nga Zoran Cirkoviç, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik G.I. Narodna Slloka me seli në Lipjan, dega në Lipjan , me shenjën ZL.Anr.635/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017 në ora 12:40, nga Zoran Cirkoviç, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik G.I.Narodna Slloka, me seli në Lipjan, dega në Lipjan, me të cilën pretendon se nga informatat që kemi marrë nga terreni, votat tona janë shpallur si të pavlefshme dhe të njëjtat janë numëruar gabimisht në vendvotimet 1301e, 1301x, 1302e, 1303e, 1310e, 1311e, 1315e, 1319e, 1320e dhe 1329e,.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në ankesën e parashtuar nuk e ka potencuar se sa vota i mungojnë në vendvotimet, 1301e, 1301x, 1302e, 1303e, 1310e, 1311e, 1315e, 1319e, 1320e dhe 1329e, si dhe në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë vetëm i ka përmendur disa Qendra të Votimit QV, duke mos i vërtetuar asnjë pretendimet e tij se në

cilat vendvotime VV më konkretisht janë hudhur fletvotimet si të pa vlefshme dhe po ashtu sipas dispozitës së nenit 117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: “*se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”. Paneli gjatë vendosjes për një ankesë i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në ankesë dhe kur vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të provuara me prova nga parashtruesi i ankesës, siç është në rastin konkret, ku parashtruesi i ankesës nuk e ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e tij, e refuzon ankesën si të pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

Anr.635/2017 më datën 10.11.2017.



Kryesuesi i Panelit

Gylene Sylejmani

Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*